L I G J
Nr. 9572, datë 3.7.2006

PËR AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE

(Ndryshuar me ligjet; nr. 10197[1], datë 10.12.2009; nr. 54/2014, datë 5.6.2014)
(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për krijimin, përgjegjësitë dhe funksionimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që në vijim do të quhet "Autoriteti".

Neni 2
Fusha e veprimtarisë së Autoritetit
(Ndryshuar shkronja "c" me ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009)

Fusha e veprimtarisë së Autoritetit është rregullimi dhe mbikëqyrja:

a) e tregut të titujve dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në tituj e që veprojnë në këtë treg;

b) e tregut të sigurimeve dhe e veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari;

c) e tregut të pensioneve private dhe të veprimtarisë së këtij tregu;

ç) e veprimtarive të tjera financiare jobankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës, që në vijim do të quhen "tregje financiare që mbikëqyren ".

KREU II
STATUSI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I AUTORITETIT

Neni 3
Statusi i Autoritetit
(Ndryshuar paragrafi i parë dhe shtuar paragraf me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Autoriteti është person juridik, publik, me qendër në Tiranë. Autoriteti është i pavarur në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin në fuqi dhe nuk lejohet

---

[1] *Ligji nr. 10197, datë 10.12.2009 në nenin 111 "Shfuqizime" , pika 2 parashikon;*
" 2. Në ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", të gjitha dispozitat, që parashikojnë rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve private të pensioneve suplementare, të cilat bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen."

ndërhyrja në veprimtarinë e tij, e cila mund të cenojë pavarësinë e Autoritetit.

Autoriteti ka të drejtë të nxjerrë akte, që janë rregulloret, rregullat, udhëzimet, manualet apo metodologjitë e miratuara nga Bordi i Autoritetit, në zbatim të kompetencave të parashikuara në këtë ligj apo në legjislacionin përkatës në fuqi, për përmbushjen e funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse, si dhe për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit.

Autoriteti, për veprimtarinë që ushtron, në përputhje me këtë ligj, raporton në Kuvend.

Neni 4

Bordi i Autoritetit

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Organi vendimmarrës i Autoritetit është Bordi, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët, një kryetar, një drejtor i përgjithshëm ekzekutiv, një nëndrejtor ekzekutiv dhe dy anëtarë të tjerë.

Neni 5

Kërkesat për t'u emëruar anëtar i Bordit

(Ndryshuar pika 2, togfjalësh në paragrafin e parë të pikës 3, pika 7, shtuar paragrafi i parë pas pikës 7, ndryshuar paragrafi i dytë pas pikës 7 dhe togjalësh në paragrafin e tretë pas pikës 7 me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Anëtarët e Bordit janë:

1. Shtetas shqiptarë.

2. Të ketë përfunduar ciklin e plotë të studimeve universitare në një nga këto fusha: ekonomi, juridik ose të lidhur me shkencën e aktuarëve.

3. Me përvojë profesionale të paktën 7- vjeçare, nga e cila, të paktën, 5 vjet në njërën nga këto fusha ose në disa prej tyre të marra së bashku:

a) financë-kontabilitet;

b) administrim i shoqërive tregtare;

c) këshillim ligjor i shoqërive tregtare;

ç) hartim legjislacioni;

d) shkencë e aktuarëve;

dh) sigurime shoqërore dhe pensione.

4. Me integritet moral dhe profesional.

5. Të paangazhuar në funksione drejtuese partiake.

6. Të pashpallur si të dënuar penalisht, me vendim gjykate të formës së prerë.

7. Në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për konfliktin e interesave.

Nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Autoritetit persona, të cilët:

a) në tre vitet e fundit kanë qenë ortakë, aksionarë, apo anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të mbikëqyrura;

b) kanë lidhje familjare me personat e parashikuar në shkronjën "a" të këtij paragrafi;

c) në tre vitet e fundit kanë qenë punonjës me kohë të pjesshme apo të plotë në subjektet e mbikëqyrura.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtori ekzekutiv i Autoritetit nuk mund të ushtrojnë veprimtari tjetër me pagesë, me përjashtim të mësimdhënies, veprimtarive kërkimore shkencore, apo pjesëmarrjes në organizata vendase apo ndërkombëtare, që kanë lidhje me veprimtarinë e Autoritetit.

Kryetari dhe dy anëtaret e tjerë të Bordit mund të jenë të punësuar me kohë të plotë në detyra të tjera, por nuk lejohen të jenë anëtarë të më shumë se 1 bordi apo organi vendimmarrës të ndonjë autoriteti tjetër mbikëqyrës.

Çdo anëtar i Bordit ka detyrimin të deklarojë përpara Kryetarit të Kuvendit, në lidhje me rrethanat e parashikuara në këtë nen.

Neni 6

Emërimi i anëtarëve të Bordit

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi.

Kryetari emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, pas një procedure përzgjedhëse.

Anëtari i Bordit, që do të mbajë funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, pas një procedure përzgjedhëse.

Anëtari i Bordit, që do të mbajë funksionin e nëndrejtorit ekzekutiv, emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Ministrit të Financave, pas një procedure përzgjedhëse.

Dy anëtarët e tjerë emërohen nga Kuvendi, me propozimin, përkatësisht, nga Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pas një procedure përzgjedhëse.

Kandidati i propozuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë nuk mund të jetë anëtar i këtij Këshilli.

Neni 7

Mandati i anëtarëve të Bordit

(Ndryshuar paragrafi i parë, i katërt dhe togfjalësh në paragrafin e tretë, shfuqizuar fjalia e dytë e paragrafit të dytë me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Mandati i çdo anëtari të Bordit është 5 vjet. Në rastet kur mandati i anëtarit ka përfunduar, secili prej tyre qëndron në detyrë deri në çastin e zgjedhjes së anëtarëve të rinj, por jo më shumë se tre muaj. Tre muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtari të Bordit, Autoriteti njofton me shkrim Kuvendin, i cili fillon praktikat për zgjedhjen e anëtarit të ri.

Anëtarët e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare mund të rizgjidhen për një mandat të dytë pas përfundimit të mandatit të tyre.

Në përfundim të mandatit, anëtari i Bordit nuk mund të punësohet për një periudhë trevjeçare apo të përfshihet në shërbime me pagesë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga ndonjëri prej subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti.

Personi që ka qenë i emëruar në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv dhe i ka mbaruar mandati, pas largimit nga detyra, kur nuk është i punësuar, përfiton një vit nga e drejta për shpërblim në vlerën e pagës që ka pasur, kur ka qenë në detyrë. Në rast punësimi, kur paga që marrin është më e vogël se ajo e parashikuar në këtë paragraf, ata kompensohen deri në, por në asnjë rast mbi, nivelin e pagës së muajit të fundit të përfituar gjatë detyrës, brenda një viti nga dorëzimi i detyrës. Pagesat e kryera në favor të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nëndrejtorit ekzekutiv, sipas përcaktimeve të këtij paragrafi, përballohen nga Autoriteti dhe parashikohen si pjesë e buxhetit të Autoritetit. Nga kjo e drejtë nuk përfiton individi i riemëruar anëtar i Bordit, si dhe ai që është liruar nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 8.

Neni 8

Lirimi nga detyra i anëtarit të Bordit

Kuvendi vendos lirimin nga detyra të anëtarit të Bordit përpara afatit të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 7 të këtij ligji, në rastet kur:

a) jep dorëheqjen;

b) bëhet fizikisht i paaftë për të përmbushur detyrën, për të cilën është emëruar, për më shumë se 3 muaj;

c) për shkak të rrethanave të reja nuk respektohen kërkesat e parashikuara në pikat 5 e 6 të

paragrafit të parë të nenit 5, si dhe kushtet e parashikuara në paragrafët e dytë, të tretë dhe të katërt të nenit 5 të këtij ligji;

ç) në rast të mungesës pa arsye në më shumë se tri mbledhje radhazi;

d) gjatë ushtrimit të funksioneve vepron në kundërshtim me detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit;

dh) për shkak të paaftësisë profesionale apo neglizhencës i shkakton dëm Autoritetit ose imazhit të tij si institucion i pavarur;

e) humbet nënshtetësinë shqiptare.

Propozimi për lirimin nga detyrara të anëtarit të Bordit i paraqitet Kuvendit nga vetë Bordi ose nga secili prej institucioneve, që kanë të drejtën e propozimit të anëtarëve të Bordit, si dhe nga institucione të tjera publike, funksioni i të cilave është i lidhur me atë të Autoritetit. Në propozimin për largimin e anëtarit përcaktohen arsyeja dhe provat në lidhje me rastin. Kuvendi mund të vendosë pezullimin e anëtarit nga funksioni deri në përfundimin e procesit të verifikimit dhe të marrjes së vendimit. Kuvendi, pas shqyrtimit, vendos lirimin ose jo nga detyra të anëtarit.

Në rast të lirimit nga detyra të ndonjërit prej anëtarëve të Bordit përpara afatit, anëtari tjetër emërohet me të njëjtën procedurë, siç është emëruar anëtari që lirohet, për periudhën deri në përfundim të mandatit të anëtarit që lirohet.

Neni 9

Struktura organizative, pagat dhe trajtimet e tjera të Autoritetit

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Bordi përcakton strukturën organizative të Autoritetit, numrin e punonjësve, pagën, shpërblimet dhe trajtimet financiare të anëtarëve joekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, nëndrejtorit ekzekutiv, si dhe të punonjësve. Trajtimet financiare përfshijnë mbulimin e shpenzimeve të kryera në përmbushje të detyrës, pagesat për trajnimet profesionale, për sigurimin e jetës dhe të shëndetit dhe të tjera të ngjashme. Bordi, në përcaktimin e masës së pagës, shpërblimeve dhe trajtimeve financiare apo jofinanciare të administratës, bazohet në një metodologji të qartë, që merr parasysh kushtet e tregut, përvojat e autoriteteve të tjera që kryejnë aktivitetin e rregullatorit financiar në Shqipëri dhe nevojat e vetë institucionit.

Autoriteti, mund të krijojë një plan të pensionit profesional për punëmarrësit e tij.

Përcaktimet e bëra në dispozitat e ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", dhe çdo përcaktim tjetër ligjor, si edhe përcaktimet e akteve nënligjore në fuqi për zbatimin e këtyre dispozitave, që bien në kundërshtim me këtë nen, nuk zbatohen për Autoritetin.

Neni 10

Mbledhjet e bordit

(Ndryshuar paragrafi i dytë dhe i gjashtë, togfjalësh në paragrafin e tretë dhe të katërt me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Mbledhjet e Bordit thirren me nismën e Kryetarit ose me kërkesën e secilit prej anëtarëve drejtuar Kryetarit të Bordit. Bordi mblidhet të paktën një herë në muaj për të diskutuar dhe vendosur për rendin e ditës.

Mbledhjet e Bordit drejtohen nga Kryetari dhe, në mungesë të tij, nga anëtari joekzekutiv më i vjetër në moshë.

Mbledhja e Bordit është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë.

Vendimet e Bordit janë të vlefshme kur votojnë pro të paktën 3 anëtarë.

Në votim nuk lejohet abstenimi.

Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje. Vendimet e marra në mbledhje nënshkruhen nga Kryetari dhe Drejtori i Përgjithshëm

Ekzekutiv.

Bordi miraton rregulloren për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.

Neni 11

Transparenca në veprimtarinë e Autoritetit

Bordi njofton publikisht politikat dhe praktikat që ndjek për zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, si dhe arsyet e ndryshimit të tyre.

Politika që ndjek për zbatimin e dispozitave, sipas paragrafit të parë të këtij neni, përfshijnë edhe mjetet e zgjedhura nga Autoriteti dhe të përdorura në mënyrë të pavarur prej tij, gjatë përmbushjes së objektivave të këtij ligji.

Autoriteti miraton rregulloren për procedurat e vënies në dispozicion të publikut të dokumentacionit që disponon, si dhe afatet e kushtet për mbajtjen e kopjeve të njësuara të këtij dokumentacioni.

Bordi miraton rregulloren për mënyrën dhe afatet e botimit të tyre, si dhe për hartimin dhe funksionimin e faqes së Autoritetit në internet.

KREU III

OBJEKTIVAT, KOMPETENCAT E AUTORITETIT DHE TË DREJTAT E BORDIT

Neni 12

Objektivat e Autoritetit

Në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të parashikuara në këtë ligj, Autoriteti udhëhiqet nga këta objektiva:

1. Mbrojtja e interesave të investitorëve dhe të personave të siguruar.

2. Nxitja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare që mbikëqyren.

3. Sigurimi i respektimit të ligjit.

Neni 13

Objekti i veprimtarisë së Autoritetit

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1 dhe shkronjën "c" të pikës 2 me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Autoriteti me strukturat e veta ka si objekt të veprimtarisë:

1. Rregullimin e veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura, nëpërmjet hartimit të akteve të Autoritetit, të parashikuara nga ky ligj dhe nga ligjet e fushës, si dhe botimin e udhëzimeve e materialeve shpjeguese.

2. Sigurimin e mbikëqyrjes shtetërore mbi tregun e titujve, tregun e sigurimeve, skemat e pensioneve vullnetare dhe veprimtari të tjera financiare jobankare, të cilat rregullohen e funksionojnë në përputhje me ligjet në fuqi.

Në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, Autoriteti ka të drejta të plota për:

a) miratimin, lëshimin apo refuzimin e licencave për subjektet, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare që mbikëqyren;

b) vëzhgimin dhe organizimin e mbikëqyrjes së subjekteve, që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare që mbikëqyren. Subjektet, qofshin këta individë apo persona, fizikë ose juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e përmenduara në nenin 2 të këtij ligji, në vijim do të quhen "subjekte të mbikëqyrura".

c) ndjekjen e zbatimit të këtij ligji dhe të akteve të Autoritetit, të dala në zbatim të tij e të ligjeve të fushës dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tyre dhe zbatimin e masave

shtrënguese.

Neni 14

Kompetencat e Bordit

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Bordi ushtron në mënyrë të pavarur këto kompetenca:

1. Miraton politikat e licencimit, të rregullimit dhe të mbikëqyrjes, për të nxitur zhvillimin e tregjeve financiare që mbikëqyren nga Autoriteti, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

2. Miraton rregullat, rregulloret, vendimet dhe udhëzimet për mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve e personave që ushtrojnë veprimtari në tregjet financiare që mbikëqyren nga Autoriteti, si dhe udhëzues për interpretimin dhe zbatimin e ligjeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji e të legjislacionit në fuqi.

3. Miraton të gjitha raportet që dërgon Autoriteti në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

4. Miraton, refuzon, pezullon apo heq licencat ose autorizimet për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve në tregjet financiare që mbikëqyren, si dhe rregullat përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

5. Miraton ekspertin kontabël ose shoqërinë audituese për subjektet e mbikëqyrura.

6. Miraton standarde kontabël dhe format e raportimit financiar, të detyrueshme për t'u zbatuar nga subjektet e mbikëqyrura.

7. Miraton kodin e etikës, rregulloren e funksionimit të Bordit dhe rregulloret për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit, që nxirren në zbatim të këtij ligji.

8. Miraton strategjitë, politikat dhe rregulloret e administrimit të përgjithshëm të Autoritetit, politikën e investimit në depozitat bankare apo në titujt e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe përcakton mënyrat dhe procedurat e përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë së Autoritetit.

9. Miraton rregulloren për krijimin, investimin dhe përdorimin e fondit të rezervës së Autoritetit.

10. Miraton strukturën organizative të Autoritetit dhe numrin e punonjësve si dhe përshkrimet e punës dhe ndarjet funksionale.

11. Miraton pagën, shpërblimet si dhe trajtimet financiare të anëtarëve joekzekutivë të Bordit, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, nëndrejtorit ekzekutiv, si dhe të punonjësve.

12. Miraton politikën e burimeve njerëzore dhe rregullat e punësimit.

13. Miraton rregullat për përcaktimin e elementeve të përllogaritjes dhe nivelet e tarifave që u ngarkohen subjekteve të mbikëqyrura, si dhe procedurat e arkëtimit dhe rakordimit të tyre.

14. Miraton buxhetin e Autoritetit, llojet e shpenzimeve, si dhe alokimet e përdorimin e fondit të rezervës.

15. Miraton pasqyrat financiare të Autoritetit.

16. Emëron drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm dhe miraton ekspertin kontabël ose shoqërinë audituese të Autoritetit.

17. Vendos për blerjen e shërbimit të këshillimit nga ekspertë të fushës.

18. Miraton nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit, të marrëveshjeve të shkëmbimit të informacionit me autoritete të tjera brenda dhe jashtë vendit.

19. Miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Autoritetit për vitin e mëparshëm, i cili paraqitet në Kuvend në muajin prill të çdo viti, së bashku me pasqyrat financiare të audituara.

20. Miraton raportin e mbikëqyrjes, ku paraqitet gjendja dhe perspektiva e tregjeve që mbikëqyren, i cili botohet në muajin korrik të çdo viti.

21. Vendos për masat e mbikëqyrjes dhe sanksionet ndaj subjekteve të mbikëqyrura.

22. Ushtron çdo kompetencë tjetër dhënë Autoritetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi.

Vendimet e marra janë objekt ankimi në gjykatë.

Vendimet e Bordit arsyetohen dhe publikohen në mënyrën e caktuar prej tij për publikimin e njoftimeve zyrtare.

Vendimet e Bordit me karakter individual i njoftohen menjëherë subjekteve të interesuara.

Neni 15

Kompetencat e Kryetarit të Bordit

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Kryetari i Bordit ka këto kompetenca:

1. Thërret dhe drejton mbledhjet e Bordit.

2. Paraqet rendin e ditës.

3. Urdhëron ngritjen e komiteteve të kontrollit, objektin e punës, si dhe afatet për shqyrtimin e çështjes.

4. I propozon Bordit ngritjen e komiteteve këshillimore, me qëllim hartimin e politikave për mbarëvajtjen e punës së Autoritetit.

5. Kompetenca të tjera, të akorduara me vendimmarrje të Bordit.

Neni 16

Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv

(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv organizon dhe administron veprimtarinë e Autoritetit dhe të administratës së këtij Autoriteti.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ka këto kompetenca:

1. Përfaqëson Autoritetin.

2. Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e administratës.

3. Përgjigjet para Bordit për zbatimin e vendimeve të miratuara.

4. I propozon Kryetarit të Bordit çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Bordit dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të Autoritetit dhe për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij.

5. Nxjerr urdhra dhe udhëzime në përmbushje të kompetencave të tij me karakter ekzekutiv.

6. Emëron dhe shkarkon punonjësit e Autoritetit.

7. Shkëmben të dhëna me Bankën e Shqipërisë, me institucione e agjenci të tjera qeveritare, me autoritete dhe administrata vendore, me organizata jofitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari të lidhura me tregjet financiare që mbikëqyren nga Autoriteti, si dhe me subjektet e mbikëqyrura.

8. Bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë për inspektimin në bankat depozitare të veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti.

9. Kërkon nga Banka e Shqipërisë kryerjen e inspektimeve me objekt të caktuar në banka, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vënien në dispozicion të rezultateve të inspektimit.

10. Përmbush detyra dhe përgjegjësi të tjera, në përputhje me rregulloret e brendshme të Autoritetit.

Kur Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv mungon, ose kur për shkaqe të jashtëzakonshme nuk mund të delegojë kryerjen e detyrave apo është në pamundësi për të vepruar, nëndrejtori ekzekutiv drejton Autoritetin për të siguruar mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të tij.

Neni 17

Kompetencat e anëtarëve, që nuk kanë funksione ekzekutive

(Ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Tre anëtarët e Bordit, të cilët nuk kryejnë funksione ekzekutive në Autoritet, kur kërkohet shqyrtimi i një çështjeje të veçantë, lidhur me mangësi apo shkelje të vërejtura gjatë veprimtarisë së Autoritetit dhe të strukturave të tij, funksionojnë si komitete kontrolli. Këta anëtarë shqyrtojnë dokumentacionin dhe përgatisin raporte të hollësishme, të cilat ia paaqesin Bordit. Nëse vërtetohen shkelje apo mangësi, raporti përmban rekomandime për masat që duhen marrë.

Komiteti i kontrollit mund të emërojë njërin nga anëtarët e vet si raportues, i cili shqyrton apelimet dhe ankesat ndaj vendimeve të Bordit.

Raportuesi gëzon të gjitha të drejtat për të kryer inspektim të plotë rreth çështjes. Për vendimet e apeluara, raportuesi përgatit raporte të hollësishme dhe ia paraqet ato Bordit. Nëse vërtetohen shkelje apo mangësi, raporti përmban rekomandime për masat që duhen marrë për rregullimin e gjendjes.

Bordi shqyrton raportin e paraqitur dhe vendos për masat e propozuara nëse ka të tilla.

Kuvendi vendos, nëse është e nevojshme, caktimin e auditit të jashtëm të Autoritetit.

Neni 18

Procedura e ekzekutimit të të drejtave të Bordit dhe të strukturave të Autoritetit

(Ndryshuar togfjalësh në paragrafin e dytë dhe të tretë të pikës 6 dhe paragrafi i fundit me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Në ushtrimin e të drejtave të Bordit dhe të strukturave të tjera të Autoritetit, anëtarët e Bordit dhe nëpunësit e ngarkuar për mbikëqyrjen gëzojnë, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj dhe me detyrën e ngarkuar, këto të drejta:

1. Kërkojnë nga subjektet e mbikëqyrura dhe subjektet e tjera, që kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve që rregullojnë tregjet e fushës, shpjegime me shkrim, dokumentacion, përfshirë kopje të certifikuara dokumentesh, të dhëna, si dhe verifikojnë dokumentacionin dhe raportimet e bëra. Dokumentacioni dhe të dhënat e shkruara duhet të jenë në gjuhën shqipe.

2. Marrin të dhëna për fondet dhe asetet, përfshirë titujt, në pronësi të subjekteve të mbikëqyrura.

3. Inspektojnë llogaritë, dokumentet tregtare dhe çdo dokumentacion tjetër, që ka lidhje me transanksionet e kryera.

4. Kryejnë verifikime në palë të treta, të cilat përfshijnë vetëm shqyrtimin e asaj pjese të dokumentacionit apo të veprimtarisë së palës së tretë, që ka lidhje me çështjen për të cilën është inspektuar subjekti i mbikëqyrur.

5. U kërkojnë palëve të treta të dhëna, dokumentacion, përfshirë kopje të certifikuara, të njësuara të dokumenteve, deklarata mbi llogaritë dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme për realizimin e verifikimeve.

6. Marrin pjesë në mbledhjet e organizuara nga strukturat drejtuese dhe kontrolluese të subjekteve të mbikëqyrura.

Për zbatimin e procedurave të mbikëqyrjes, nënkryetari përgjegjës për subjektin e mbikëqyrur mund t'i kërkojë Bordit emërimin e ekspertëve të jashtëm, në përputhje me kërkesat specifike të miratuara nga Bordi. Shpenzimet, në këtë rast, përballohen nga subjekti i mbikëqyrur.

Me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, bankat janë të detyruara që, për subjektet e mbikëqyrura, t'i japin Autoritetit të dhëna për numrat dhe kodet e llogarive ekzistuese apo të mbyllura, si dhe datën e transanksionit të fundit të kryer.

Të gjitha të dhënat dhe dokumentet, që përbëjnë shkelje të këtij ligji, të cilat kanë në përmbajtjen e tyre emrin e personit, që është marrë me hartimin e tyre, u dorëzohen palëve të treta nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv vetëm me miratimin paraprak të personit në fjalë, me përjashtim të rasteve kur ligji e parashikon ndryshe.

Policia, prokuroria dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore detyrohen që, brenda kompetencave të tyre, të ndihmojnë Autoritetin dhe punonjësit e tij për përmbushjen e detyrave

gjatë ushtrimit të funksioneve mbikëqyrëse.

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave të ngarkuara nga ky ligj, Autoriteti mund të ndërmarrë inspektime të përgjithshme, në bashkëpunim me organet e tatim-taksave.

Anëtarët e Bordit të Autoritetit dhe nëpunësit e tjerë të administratës së tij nuk mund të jenë individualisht përgjegjës për dëmin që mund t'u shkaktohet personave të mbikëqyrur nga veprimet apo mosveprimet e kryera gjatë ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tyre, në zbatim të këtij ligji apo të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rasteve kur veprimet apo mosveprimet janë kryer me faj dhe në mënyrë të qëllimshme. Autoriteti dëmshpërblen anëtarët e Bordit dhe nëpunësit e tjerë të administratës së tij për kostot ligjore të lindura gjatë procesit të mbrojtjes prej veprimeve ligjore të ndërmarra kundër tyre, për shkak të ushtrimit të funksioneve apo të detyrave të tyre, në zbatim të këtij ligji apo të legjislacionit në fuqi.

Neni 18/1

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit

(Shtuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

1. Autoriteti lidh marrëveshje ose memorandume bashkëpunimi me autoritete të tjera mbikëqyrëse, vendase apo të huaja, me autoritete mbikëqyrëse në sektorin financiar, agjenci apo institucione të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ose institucione të tjera të njohura me ligj, për të bashkëpunuar, shkëmbyer informacione, apo kryer inspektime të përbashkëta.

2. Autoriteti kryen hetime, në emër dhe për llogari të autoriteteve të tjera mbikëqyrëse vendase apo të huaja, në sektorin financiar të agjencive apo institucioneve të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ose institucioneve të tjera të njohura me ligj, me kërkesë të tyre.

3. Autoriteti shkëmben me autoritetet dhe institucionet vendase apo të huaja, sipas fushave përkatëse të veprimtarisë:

a) informacion për subjektet e mbikëqyrura;

b) informacion për lëshimin e licencave;

c) informacion që lidhet me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

ç) informacion që lidhet me mashtrimin gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushat e mbikëqyrura;

d) të dhëna të natyrës financiare;

dh) informacion për personat fizikë, të cilët mbajnë poste me përgjegjësi në këto subjekte.

4. Çdo informacion që merr Autoriteti dhe çdo informacion që i jepet një autoriteti tjetër mbikëqyrës trajtohet si konfidencial dhe përdoret vetëm për qëllime të përcaktuara në ligj apo në akte nënligjore.

5. Autoriteti është përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit rreth fakteve dhe rrethanave që lidhen me përmbushjen e detyrave të tij mbikëqyrëse dhe përgjegjësive të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 19

Inspektimi

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Inspektimi ushtrohet nga nëpunësit e Autoritetit, sipas përcaktimit të bërë në urdhrin e nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, ose, në mungesë dhe me autorizimin e lëshuar prej tij, nga nëndrejtori ekzekutiv. Inspektimi bëhet me ose pa paralajmërim.

Nëpunësit e urdhëruar, në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, inspektojnë për:

1. Respektimin e dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e tregjeve financiare që mbikëqyren.

2. Parandalimin dhe identifikimin e shkeljeve.

Për ushtrimin e inspektimit, subjekti i mbikëqyrur është i detyruar t'u sigurojë nëpunësve të Autoritetit kushte normale pune, si dhe t'u ofrojë dokumentacion ose çdo të dhënë tjetër, të shkruar në gjuhën shqipe.

Nëpunësit e administratës së Autoritetit, para fillimit të procedurave të inspektimit, janë të detyruar të paraqesin urdhrin e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

Subjekti i mbikëqyrur është i detyruar t'u ofrojë Autoritetit dhe administratës së tij:

a) mjetet e nevojshme për inspektim, nëse i kërkohet kjo, si dhe t'u përgjigjet pyetjeve në mjediset e Autoritetit;

b) personat e kontaktit, nga radhët e të punësuarve, për të ndihmuar në kryerjen e inspektimit;

c) hyrje pa limit në mjediset e zyrave;

ç) të gjitha llogaritë, dokumentacionin tregtar dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm, për të përcaktuar faktet dhe rrethanat, në lidhje me çështjet për të cilat kryhet inspektimi;

d) pas një kërkese paraprake, fotokopjet e llogarive dhe të dokumenteve të tjera, ku të shënohet me shkronja shtypi "E njëjtë me origjinalin", si dhe data dhe nënshkrimi i personit të autorizuar nga personi i inspektuar.

Raporti për çdo inspektim përgatitet në dy kopje dhe nënshkruhet nga nëpunësi i Autoritetit, që kryen inspektimin, si dhe i paraqitet për kundërfirmë personit që përfaqëson subjektin e mbikëqyrur.

KREU IV
ADMINISTRATA E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES

Neni 20
Organizimi dhe detyrimet

(Ndryshuar togfjalësh në paragrafin e parë dhe paragrafi i dytë me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Veprimtaria e Autoritetit mbështetet nga një administratë, që funksionon në përputhje me rregulloren e brendshme të përshkrimit të punës dhe me rregulloret e tjera për funksionimin e administratës, të cilat miratohen nga Bordi, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.

Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Autoritetit rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji, si dhe të akteve të Autoritetit.

Nuk mund të punësohen në strukturat e Autoritetit persona:

a) të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë;

b) të cilët janë ortakë apo aksionerë të subjekteve të mbikëqyrura;

c) që kanë qenë anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të mbikëqyrura në dy vitet e fundit;

ç) që kanë lidhje familjare me personat e parashikuar në shkronjën "c" të këtij neni, me anëtarët e Bordit apo me punonjës të tjerë të administratës, me të cilët kanë lidhje hierarkike;

d) që janë punonjës me kohë të pjesshme apo të plotë në subjektet e mbikëqyrura;

dh) që nuk gëzojnë integritet moral dhe profesional dhe për të cilët janë marrë masa disiplinore për cenim të rregullave të etikës.

Neni 21
Shpërblimi i administratës

(Shfuqizuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

KREU V
DEKLARIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT

Neni 22
Konflikti i interesit

Anëtarët e Bordit dhe nëpunësit e Autoritetit janë të detyruar të bëjnë deklarimin e pasurisë në çastin e marrjes së detyrës, si dhe më tej, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Anëtarët e Bordit nuk marrin pjesë në procedurat e diskutimit, votimit dhe vendimmarrjes, nëse kanë interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për çështjen, interes i cili cenon paanësinë e tyre në vendimet që do të merren, si dhe me qëndrimet zyrtare.

Nëpunësi i Autoritetit nuk merr pjesë në inspektime ndaj subjekteve të mbikëqyrura nëse ka interesa, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për çështjen për të cilën kryhet inspektimi, interes i cili cenon paanësinë e tyre.

Anëtarët e Bordit dhe nëpunësit e Autoritetit, nëse vërejnë se ndodhen përpara rastit të parashikuar, përkatësisht, në paragrafin e dytë ose të tretë të këtij neni, bëjnë deklaratat me shkrim për këtë fakt dhe tërhiqen nga shqyrtimi i çështjes.

Në rast se vërehet se megjithëse janë ndodhur përpara rastit të përmendur, përkatësisht, në paragrafin e dytë apo të tretë të këtij neni dhe nuk kanë bërë deklarimin përkatës e për pasojë nuk janë tërhequr nga shqyrtimi i çështjes, ndaj tyre merret masa e lirimit ose e largimit nga detyra. Masa e lirimit ose e largimit nga detyra nuk ndikon në vendimet e marra deri në atë çast.

KREU VI
KODI ETIK, PROFESIONALIZMI DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 23
Kodi etik dhe profesionalizmi
(Ndryshuar togfjalësh në paragrafin e parë me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Anëtarët e Bordit, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, zbatojnë kodin e etikës dhe standardet profesionale, të miratuara nga Bordi, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.

Kur vërehen shkelje të kodit të etikës, merren masa disiplinore deri në lirimin ose largimin nga detyra.

Neni 24
Konfidencialiteti

Të dhënat, që i vihen në dispozicion Autoritetit për veprimtarinë e subjektit të mbikëqyrur, klasifikohen "Informacion konfidencial" nëse përhapja e tyre cenon interesat tregtarë ose emrin e mirë të subjektit.

Nuk janë informacione konfidenciale të dhënat tregtare, të siguruara nga subjekti i mbikëqyrur, detyrimi për botimin e të cilave është parashikuar nga ky ligj apo nga ligje të tjera. Klasifikimi i informacionit bëhet me rregullore të brendshme, të miratuar nga Bordi.

Anëtarët e Bordit, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit janë të detyruar t'i ruajnë dhe të mos i shpërndajnë informacionet konfidenciale.

Për rastet kur vërtetohen shkelje të detyrimeve të parashikuara në këtë nen, merren masa administrative deri në lirimin nga detyra, për anëtarët e Bordit, ose largimin nga detyra, për nëpunësit e tjerë të Autoritetit.

Neni 25
Përfundimi i trajtimit si informacion konfidencial

Informacioni i klasifikuar konfidencial nuk trajtohet më si i tillë me kalimin e tre viteve nga çasti kur i është dorëzuar Autoritetit. Ky afat mund të zgjatet me vendim të Bordit.

Bëjnë përjashtim nga respektimi i afatit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni rastet kur ky informacion kërkohet nga:

1. Autoritetet gjyqësore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

2. Autoritetet mbikëqyrëse bankare apo shërbimet inteligjente, sipas kritereve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshje të përbashkëta.

3. Autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera, që ushtrojnë veprimtari të njëjtë ose të ngjashme me atë të Autoritetit, në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta për shkëmbim të dhënash, kur këto autoritete:

a) sigurojnë të paktën të njëjtin nivel konfidencialiteti për të dhënat që dërgohen;

b) bien dakord që, me kërkesë të Autoritetit, të vënë në dispozicion të njëjtën të dhënë;

c) kanë arsye për kërkesën për informacion.

Në dhënien e këtij informacioni zbatohen dispozitat ligjore për të dhënat personale.

Të dhënat e marra nga subjekti i mbikëqyrur mund t'i rijepen atij në çdo kohë.

KREU VII
FINANCIMI DHE BUXHETI I AUTORITETIT

Neni 26
Financimi dhe buxheti
(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Autoriteti është institucion financiarisht i pavarur dhe financohet me burime të veta.

Të ardhurat e Autoritetit krijohen nga:

a) tarifat e mbledhura, në zbatim të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi;

b) gjobat e vendosura, në zbatim të këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe penalitetet e vendosura për pagesat e vonuara të tarifave, të përcaktuara në nenin 27 të këtij ligji;

c) dhënia me qira e ambienteve në pronësi të Autoritetit;

ç) investimi në depozita bankare apo titujt e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë;

d) burime dhe veprimtari të tjera të lejuara nga ky ligj ose legjislacioni në fuqi.

Të ardhurat e Autoritetit përdoren:

a) për të mbuluar shpenzimet që kryen Autoriteti në përmbushje të përgjegjësive të tij, të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin në fuqi;

b) për të kryer investime apo zbatuar projekte në përmbushje të përgjegjësive të tij, të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin në fuqi;

c) për të krijuar dhe mbajtur fondin e rezervës. Me "fond rezervë", për qëllime të këtij ligji, kuptohet fondi, në të cilin alokohet diferenca pozitive ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit ushtrimor dhe që shërben për të mbuluar diferencën negative ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit ushtrimor. Alokimi i të ardhurave në fondin e rezervës kryhet derisa ky fond të arrijë nivelin mesatar gjashtëmujor të buxhetit të Autoritetit për tre vitet e fundit.

Neni 27
Përcaktimi i tarifave për subjektet e mbikëqyrura
(Ndryshuar me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Autoriteti mbledh nga subjektet e mbikëqyrura:

1. Tarifa për aplikim, dhënie e rinovime licencash, miratimesh dhe autorizimesh, sipas përcaktimeve të këtij ligji, të legjislacionit në fuqi apo rregulloreve të Autoritetit.

2. Tarifa për mbikëqyrjen e subjekteve të mbikëqyrura, të licencuara nga Autoriteti.

3. Tarifa për projekte të veçanta, prej të cilave përfitojnë subjektet e mbikëqyrura. Të ardhurat nga këto tarifa përdoren vetëm për financimin dhe mirëmbajtjen e këtyre projekteve.

Tarifa për mbikëqyrjen e subjekteve të mbikëqyrura caktohet në nivelin deri në 1,5 për qind të:

a) volumit të primeve të shkruara bruto vjetore nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit të jojetës;

b) volumit të primeve të shkruara, pasi janë zbritur elementet e kursimit, vjetore, nga veprimtaria e sigurimit dhe risigurimit të jetës;

c) vlerës së përgjithshme të aseteve të fondit të pensioneve vullnetare dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive;

ç) volumit të përgjithshëm të transaksioneve vjetore të realizuara në bursë apo në një treg të rregulluar;

d) treguesit të përzgjedhur si bazë në këtë ligj, në legjislacionin në fuqi apo në rregulloret e Autoritetit për subjektet e tjera të mbikëqyrura, që nuk përcaktohen në shkronjat "a" deri në "ç" të këtij paragrafi.

Rakordimi përfundimtar i shumës së tarifës së mbikëqyrjes për t'u paguar kryhet brenda një muaji nga paraqitja në Autoritet e pasqyrave financiare të audituara të subjektit të mbikëqyrur ose nga paraqitja e pasqyrave financiare vjetore përfundimtare, për ato subjekte që nuk kanë detyrim auditimi ligjor.

Tarifat e paguara nga subjekti i mbikëqyrur llogariten si shpenzim i zbritshëm për efekte tatimore, kur plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 20, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar. Kur fondi i rezervës është në nivelin e përcaktuar në shkronjën "c", të nenit 26, të këtij ligji, çdo tepricë që mbetet nga të ardhurat vjetore të Autoritetit njihet dhe regjistrohet si paradhënie e subjekteve të mbikëqyrura për periudhën pasardhëse, duke e shpërndarë në mënyrë përpjesëtimore me kontributin e tyre.

KREU VIII
KONTABILIZIMI DHE KONTROLLI I VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT

Neni 28
Raportimi dhe kontrolli

Brenda muajit prill të vitit pasardhës, Autoriteti i paraqet Kuvendit:

1. Raportin vjetor për veprimtarinë e tij.
2. Deklarimin për gjendjen financiare vjetore.
3. Raportin për realizimin e planit të buxhetit.

Raporti vjetor për veprimtarinë e Autoritetit, përveç të dhënave që mund të kërkohen nga Kuvendi, përmban të dhëna për:

1. Përshtatshmërinë e infrastrukturës ligjore të tregut financiar të mbikëqyrur.
2. Vendimet e marra për dhënien e licencave, miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative, të nxjerra në përputhje me këtë ligj, refuzimin e lëshimit të licencave apo të kërkesave të tjera, që i janë paraqitur Autoritetit, regjistrimet e bëra në regjistra, vendimet e ankimuara të Bordit dhe, në mënyrë të hollësishme, ankimimet e vendimeve të Bordit, të cilat janë pranuar nga gjykata.
3. Rezultatin e inspektimeve të subjekteve të mbikëqyrura.
4. Politikat e ndjekura për vënien në dijeni të publikut, si dhe ato të bashkëpunimit të brendshëm e ndërkombëtar.
5. Organizimin, financimin dhe politikat për përzgjedhjen e nëpunësve dhe të punonjësve të tjerë.
6. Të dhëna të tjera, sipas vendimit të Bordit.

KREU IX
REGJISTRAT E AUTORITETIT

Neni 29

Regjistrat

(Ndryshuar togfjalësh në paragrafin e fundit me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Autoriteti mban regjistra të hapura për publikun për:

1. Shoqëritë, që ushtrojnë veprimtaritë si tregje të titujve (bursa).
2. Shoqëritë publike dhe emetuesit e tjerë të titujve.
3. Shoqëritë e investimit.
4. Shoqëritë administruese të fondeve të investimit dhe institutet private të pensioneve.
5. Fondet e investimit.
6. Tregtarët e titujve dhe këshilltarët e investimeve.
7. Shoqëritë e sigurimeve.
8. Agjentët e sigurimeve.
9. Shoqëritë që ushtrojnë veprimtari si institute private të pensioneve.

Bordi, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, miraton regjistra të tjerë dhe procedura për regjistrimin fillestar, mbajtjen dhe ruajtjet e regjistrave, si dhe procedurat që sigurojnë mirëfunksionimin e regjistrit, si një sistem informativ i plotë.

KREU X

GRUPI KËSHILLIMOR I STABILITETIT FINANCIAR (GKSF)

Neni 30

Funksionimi i GKSF-së

Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar, më poshtë GKSF, krijohet si një njësi këshillimore që:

1. Asiston në zhvillimin e politikave të përbashkëta, në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimeve të anëtarëve të këshillit sa herë që është e nevojshme të kryhen inspektime në subjektet e mbikëqyrura.

2. Siguron shkëmbimin e informacionit ndërmjet anëtarëve të grupit.

3. Asiston në ruajtjen, stabilitetin dhe zhvillimin e tregjeve financiare në Republikën e Shqipërisë.

4. Asiston në përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të kontrollit mbi pjesëmarrësit e tregjeve financiare.

Anëtarë të GKSF-së janë:

- Ministri i Financave;
- Kryetari i Bordit të Autoritetit;
- Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

Me ftesë të GKSF-së, në mbledhjet e tij mund të marrë pjesë edhe Kryetari i Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat dhe persona të tjerë.

GKSF-ja i bën secilit prej përfaqësuesve rekomandime dhe propozime, që kanë si qëllim përmirësimin e praktikave të plotësimit dhe zgjerimit të infrastrukturës ligjore për tregjet financiare.

Të drejtën për të thirrur mbledhjen e GKSF-së e ka çdo anëtar.

Mbledhjet e GKSF-së kryesohen nga Ministri i Financave. Mbledhja e parë e GKSF-së thirret nga Ministri i Financave brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

KREU XI

SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 31

Gjobat

(Ndryshuar fjalia e parë e paragrafit të fundit me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Cilido person, që pengon Autoritetin e Mbikëqyrjes, strukturat e tij ose nëpunësit e autorizuar të administratës së tij në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara nga ky ligj ose nga çdo akt tjetër, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë dhe, në rast përsëritjeje të shkeljes, nga 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Çdo shkelje, sipas paragrafit të parë të këtij neni, e kryer nga persona që janë ortakë ose aksionerë të personit juridik, që kanë funksione drejtuese të personit juridik apo nga ortakë të vetëm të një shoqërie tregtare, dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë dhe në rast përsëritjeje të shkeljes, nga 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë deri në 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Njoftimi për vendimin e marrë nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv. Ankimimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimit të Bordit.

KREU XII
KOMPETENCA E AUTORITETIT PËR ZBATIMIN E MASAVE ADMINISTRATIVE

Neni 32
Përdorimi i masave administrative

(Ndryshuar togfjalësh në paragrafin e parë me ligjin nr. 54/2014, datë 5.6.2014)

Bordi, për parandalimin apo ndërprerjen e veprimeve që përbëjnë shkelje të ligjit dhe të akteve të Autoritetit në zbatim të tij, parandalimin apo ndërprerjen e pasojave të rënda të shkeljeve të ligjit dhe në rastet e pengesave për ushtrimin e veprimtarisë mbikëqyrëse të Autoritetit, mund të miratojë vendime për subjektet e mbikëqyrura, të cilat duhet të trajtojnë mënyrën që duhet të ndjekin subjektet e mbikëqyrura për të korrigjuar situatën apo për të parandaluar dëmin. Këto vendime përcaktojnë afate për kryerjen e ndryshimeve apo korrigjimin e veprimeve, si dhe mund të parashikojnë detyrimin për ndryshimin e administratorëve ose të drejtuesve, në rastet kur vërehen veprime në kundërshtim me ligjin.

Autoriteti mund ta vërë në dijeni publikun për masat e marra në zbatim të paragrafit të parë të këtij neni.

KREU XIII
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 33
Përfundimi dhe transferimi i kompetencave

Në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfundojnë kompetencat vendimmarrëse:

1. Të Komisionit të Letrave me Vlerë, të krijuar me ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 "Për letrat me vlerë", të ndryshuar.

2. Të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, të krijuar me ligjin nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve" , të ndryshuar.

3. Të Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve, të krijuar me ligjin nr. 7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", të ndryshuar.

Mjetet, burimet e të ardhurave, arkivat, detyrimet dhe kompetencat e tjera të Komisionit të Letrave me Vlerë, të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Institutive Private të Pensioneve, i kalojnë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Ky proces përfundon në çastin e shkrirjes së administratës së tri institucioneve të para.

Tarifat e zbatuara deri tani nga Komisioni i Letrave me Vlerë, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Inspektorati i Instituteve Private të Pensioneve mbeten në fuqi dhe zbatohen nga Autoriteti deri në miratimin e pagesave, sipas nenit 27 të këtij ligji.

Neni 34

Emërimi i anëtarëve të Bordit të parë

Brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, institucionet përgjegjëse paraqesin në Kuvend propozimet për anëtarët e Bordit.

Brenda 10 ditëve nga marrja e propozimeve, Kuvendi emëron anëtarët e Bordit.

Emërimi i anëtarëve të Bordit të parë bëhet sipas afateve të mëposhtme:

1. Kryetari 5 vjet.

2. Njëri prej nënkryetarëve 5 vjet dhe tjetri 4 vjet, sipas përcaktimit të bërë në vendimin e emërimit.

3. Anëtarët, përkatësisht njëri 5 vjet, njëri 4 vjet dhe dy të tjerët nga 3 vjet, sipas përcaktimit të bërë në vendimin për emërimin e tyre.

Kryetari thërret mbledhjen e parë të Bordit brenda 7 ditëve nga emërimi. Mbledhja e parë e Bordit organizohet në mjediset e përcaktuara në lajmërimin e thirrjes së bërë nga Kryetari.

Neni 35

Mbarimi i funksioneve dhe shkrirja e administratave të Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë së vepruari organet vendimmarrëse të Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve, si dhe përfundon mandati i anëtarëve të zgjedhur ose të emëruar në organet vendimmarrëse të këtyre institucioneve.

Licencat dhe vendimet e tjera individuale administrative, të lëshuara deri në datën e miratimit të këtij ligji nga organet e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, mbeten në fuqi.

Brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, shkrihen administratat e Komisionit të Letrave më Vlerë, të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe të Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve. Gjatë kësaj periudhe, Kryetari, sipas procedurave të miratuara nga Bordi, fillon punën për rekrutimin e nëpunësve dhe të punonjësve të tjerë të Autoritetit, duke trajtuar me përparësi të punësuarit në këto institucione. Gjatë kësaj periudhe, personat që ushtrojnë funksione ekzekutive në këto administrata nuk kanë më asnjë kompetencë vendimmarrëse për lëshimin e licencave apo zgjerimin e tyre. Ata janë përgjegjës për dorëzimin te Kryetari i Autoritetit të mjeteve, burimeve të të ardhurave, arkivave dhe detyrimeve të tjera, të përmendura në paragrafin e fundit të nenit 33 të këtij ligji.

Nëpunësit e Komisionit të Letrave me Vlerë, të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve, të cilët nuk do të rekrutohen nga Autoriteti, përfitojnë të drejtat e parashikuara nga ligji "Statusi i nëpunësit civil".

Neni 36

Caktimi i pagave, shpërblimeve dhe strukturës për vitin e parë financiar

Struktura e Autoritetit, paga e Kryetarit, e nënkryetarit dhe shpërblimi i anëtarëve të tjerë të Bordit për vitin 2006 caktohen nga Këshilli i Ministrave brenda 7 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 37

Buxheti i Autoritetit për vitin e parë financiar të veprimtarisë

Buxheti i Autoritetit për vitin 2006 hartohet mbështetur në buxhetin e Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve.

Ngarkohet Ministri i Financave të bëjë ndryshimet e nevojshme për përgatitjen e buxhetit të vitit 2006 për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

KREU XIV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 38
Terminologjia

Në këtë ligj, termat kanë të njëjtin kuptim si në ligjet që rregullojnë secilin prej tregjeve financiare që mbikëqyren, që janë objekt i mbikëqyrjes nga Autoriteti.

Në këtë ligj, termi "tituj" ka të njëjtin kuptim me termin "letra me vlerë".

Neni 39
Hartimi i rregulloreve të Autoritetit

Bordi, brenda dy muajve nga mbledhja e tij e parë, harton dhe miraton rregulloren e parashikuar në paragrafin e katërt të nenit 9 të këtij ligji.

Bordi, brenda 6 muajve nga mbledhja e tij e parë, harton dhe miraton rregulloret e tjera për drejtimin e përditshëm të institucionit.

Neni 40
Shfuqizime

Ligji nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve", shfuqizohet.

Aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjeve nr.8080, datë 1.3.1996 "Për letrat me vlerë", të ndryshuar, nr. 9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", të ndryshuar, dhe nr. 7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", të ndryshuar, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Të gjitha aktet nënligjore, të miratuara nga autoritetet e rregulluara nga ligjet e përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, shfuqizohen.

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, rishqyrton dhe miraton të gjitha aktet nënligjore, të cilat miratoheshin nga autoritetet e rregulluara nga ligjet e përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni.

Neni 41
Ndryshimet në ligjin nr. 8080, datë 1.3.1996 "Për letrat me vlerë", të ndryshuar

Në ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 "Për letrat me vlerë" të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në ligj fjala "Komision" zëvendësohet me fjalën "Autoriteti".
2. Kreu II dhe Kreu X shfuqizohen.
3. Pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 64 shfuqizohen.
4. Neni 67 shfuqizohet.

Neni 42

Ndryshimet në ligjin nr. 7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", të ndryshuar

Në ligjin nr. 7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 4 e 5 të nenit 1 shfuqizohen.

2. Në pikën 10 të nenit 1 dhe kudo në ligj, ku është përdorur, termi "depozitëmarrës" zëvendësohet me termin "depozitar".

3. Në nenin 19 fjala "inspektorët" zëvendësohet me fjalët "nëpunësi i urdhëruar".

4. Kudo në ligj fjala "leje" zëvendësohet me fjalën "licencë".

5. Kudo në ligj emërtesa "Inspektorat "zëvendësohet me emërtesën "Autoriteti".

6. Kreu XI shfuqizohet.

Dispozitë kalimtare

(Parashikuar në ligjin nr. 54/2014, datë 29.5.2014)

Kryetari i Bordit, nënkryetaret dhe anëtaret e tjerë, të zgjedhur në këtë funksion para hyrjes në fuqi të këtij ligji, qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e Bordit të ri.

Brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kuvendi miraton anëtarët e rinj të Bordit.

Brenda një muaji nga konfigurimi i Bordit të ri, miratohet struktura e re organizative dhe rregulloret e përshkrimit të punës dhe ndarjes së funksioneve.

Anëtarët e rinj të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të emëruar në zbatim të dispozitave të këtij ligji, kanë si rast përjashtimor, vetëm për mandatin e parë, këto afate emërimi:

a) Kryetari, 4 vjet;

b) Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, 5 vjet;

c) nëndrejtori ekzekutiv, 4 vjet;

ç) anëtarët e tjerë, 3 vjet.

Neni 43

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 4988, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu